

## Informacioni bazë | APPEAR III | 2020-2027

### Objektivi

APPEAR kontribuon në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG). Objektivi i përgjithshëm është forcimi i themelit shkencor dhe i kapaciteteve institucionale në arsimin e lartë, studimi dhe menaxhimi në vendet partnere përmes partneriteteve akademike me institucionet austriake të arsimit të lartë dhe bursave për master dhe doktoraturë. Për më tepër, APPEAR synon rritjen e angazhimit për bashkëpunimin dhe zhvillimin ndërkombëtar në institucionet austriake të arsimit të lartë.

APPEAR është një program i Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC) me qëllim që të realizojë strategjinë e tij për mbështetjen e arsimit të lartë dhe studimit për zhvillim në një nivel institucional akademik. Ai zbatohet në 11 vendet me përparësi të ADC-së dhe rajonet kryesore, të cilat ndodhen në Afrikën Lindore, Perëndimore dhe Jugore, në Azinë Jugore, Lindjen e Mesme, Kaukazin Jugor dhe Evropën Juglindore.

### Vendet e pranueshme

- Burkina-Faso, Etiopia, Uganda, Mozambiku
- Butani
- Palestina
- Armenia, Gjeorgjia
- Shqipëria, Kosova (*vlejnë kërkesa të veçanta*) dhe Republika e Moldavisë

### Fokusi tematik i programit

Forcimi i kapaciteteve institucionale në arsimin e lartë dhe studimin për zhvillim:

- Çrrënjësja e varfërisë dhe plotësimi i nevojave themelore - ujë, kanalizime, energji, siguri ushqimore, duke përfshirë një qasje lidhëse, arsim për të gjithë, mbrojtje sociale dhe punësim për të gjithë
- Të drejtat e njeriut, barazia gjinore, fuqizimi i grave dhe vajzave, migrimi
- Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik - zhvillimi i sektorit privat, ekonomia e qëndrueshme dhe zhvillimi urban, përdorimi i teknologjive dixhitale për zhvillim, sistemet e taksave dhe të ardhurat e brendshme në vendet partnere
- Mbrojtja e mjedisit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore - zbutja e ndryshimeve klimatike dhe ndikimet e tyre, mbrojtja e ekosistemeve, përdorimi i përgjegjshëm i burimeve natyrore, energjia e qëndrueshme, uji dhe kanalizimet
- Paqja, parandalimi i konflikteve, siguria dhe zhvillimi, qeverisja, ndihma humanitare

## Instrumentet

Instrumenti	Kohëzgjatja	Shuma e financimit
Financimi përgatitor	deri në 4 muaj	deri në 15 000 euro
Partneriteti akademik	deri në 4 vjet në varësi të kërkesës	Partneritetet e 2 institucioneve: 50 000 - 90 000 euro në vit  Partneritetet e më shumë se 2 institucioneve: 50 000– 130 000 euro në vit
Partneriteti i avancuar akademik	deri në 3 vjet në varësi të kërkesës	
Partneriteti institucional i ndikimit të zgjeruar	deri në 2 vjet në varësi të kërkesës	
Partneriteti i jashtëm i ndikimit të zgjeruar	deri në 3 vjet në varësi të kërkesës	

### Financimi përgatitor

Ky instrument synon të mundësojë partneritete të reja akademike midis institucioneve të arsimit të lartë austriak dhe institucioneve të arsimit të lartë dhe studimit në vendet partnere. Qëllimi i këtyre projekteve në shkallë të vogël është të përpunojnë një projekt-propozim të përbashkët për një partneritet akademik APPEAR.

### Partneriteti akademik

Ky instrument financon bashkëpunimin e thelluar dhe të qëndrueshëm akademik në arsimin e lartë, studimin dhe menaxhimin.

### Partneriteti i avancuar akademik

Ky instrument mundësohet për konsorciumet të cilat kanë përfunduar me sukses një projekt partneriteti akademik APPEAR. Financon bashkëpunimin e vazhdueshëm akademik që bazohet në rezultatet e projektit të përfunduar dhe zhvillon skema të reja novatore për bashkëpunim në arsimin e lartë dhe studimin për zhvillim.

### Partneriteti i ndikimit të zgjeruar

Ky instrument ofrohet për konsorciumet të cilat kanë përfunduar me sukses një projekt partneriteti akademik APPEAR ose një projekt partneriteti të avancuar akademik APPEAR. Qëllimi i instrumentit është të rrisë ndikimin e projekteve të përfunduara duke u përqendruar në zbatimin dhe përfundimin e rezultateve të arritura. Konsorciumet e institucioneve akademike mund të ftojnë institucionet joakademike që të marrin pjesë, nëse kërkohet, për rritjen e ndikimit. Në varësi të fokusit të partneritetit të ndikimit të zgjeruar, ai mund të diferencohet më tej në:

- **Partneritet institucional i ndikimit të zgjeruar:** synon përmirësimin e sistemeve dhe të proceseve organizative dhe infrastrukture në studimin, mësimdhënien dhe menaxhimin e institucioneve partnere të përfshira, forcon përfundimin e studimeve brenda institucioneve dhe nxit bashkëpunimin rajonal të institucioneve akademike në ndërtimin e kapaciteteve institucionale.
- **Partneritet i jashtëm i ndikimit të zgjeruar:** synon diskutimin dhe zbatimin e rezultateve të studimit me palët e interesit (komunitetet, shoqërinë civile, politikëbërësit) në mënyrë që të përdorin studimet (dëshmi për politika dhe praktikë) duke kontribuar në arritjen e SDG në praktikë.

Të gjitha instrumentet kontribuojnë në objektivin e përgjithshëm të APPEAR duke forcuar bazën shkencore dhe kapacitetet institucionale në arsimin e lartë, studimin dhe menaxhimin në vendet partnere dhe duke rritur angazhimin për bashkëpunim dhe zhvillim ndërkombëtar në institucionet e arsimit të lartë austriak. Projektet e financuara brenda këtyre instrumenteve përqendrohen në një ose më shumë fusha tematike APPEAR dhe kontribuojnë në arritjen e SDG-ve.

### **Parimet udhëzuese për hartimin dhe zbatimin e projektit**

- Qasja pjesëmarrëse
- Një koncept i njohurive kulturore me mendje të hapur
- Qasje e orientuar praktikisht dhe empirikisht
- Ndjeshmëria gjinore
- Qasja e drejtuar nga kërkesa poshtë-lart
- Nuk lihet askush pas
- Hyrje e hapur - të dhëna të hapura

### **Vlerat e shtuara - elementet të cilat merren parasysh në procesin e përzgjedhjes së projektit**

- Përafrimi me përparësitë e strategjive të vendeve ADC, përdorimi i sinergjive me projektet e vazhdueshme të financuara nga ADC
- Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në përputhje me strategjinë e diversitetit APPEAR
- Forcimi i rrjeteve rajonale dhe bashkëpunimi jug-jug
- Përparimi i studiuesve të rinj dhe veçanërisht i grave
- Aktivitete të orientuara praktikisht që rrisin zbatimin e rezultateve, studimin në përdorim dhe përfitim të studimit
- Përgjegjësia e projektit nga një institucion në vendin partner

### **Institucionet e pranueshme**

#### **Institucionet austriake:**

- Vetëm institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të marrin pjesë. Ato mund të paraqesin dhe bashkërendojnë projektin.

#### **Institucionet në vendet partnere:**

- Institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet studimore janë grupi kryesor i synuar. Ato mund të paraqesin dhe bashkërendojnë projektin.
- Institucione të tjera, si p.sh. institucione studimore dhe mësimore, OJQ-të, grupet studimore, organizatat e shoqërisë civile, kanë të drejtë të marrin pjesë si partnerë shtesë. Subjektet e sektorit privat mund të përfshihen, por nuk kanë të drejtë të marrin fonde. Institucionet e tjera nuk mund të paraqesin/bashkërendojnë një projekt.

Një projekt duhet të përbëhet nga të paktën një institucion austriak i arsimit të lartë dhe një institucion studimor ose i arsimit të lartë në një vend partner. Secili prej tyre mund të marrë rolin e koordinatorit.

Institucionet e tjera në vendet partnere mund të jenë partnerë shtesë në një konsorcium që përbëhet nga të paktën një institucion i arsimit të lartë në Austri, dhe një institucion kërkimor ose i arsimit të lartë në një vend partner.

### Institucionet partnere të asociuara:

- Ato ndodhen jashtë Austrisë dhe 11 vendeve partnere, por në një vend të renditur në listën [e marrësve të ODA në OECD DAC](#). Ato përfshijnë institucionet e arsimit të lartë, institucionet studimore, institucionet studimore dhe mësimore, OJQ-të, grupet studimore ose organizatat e shoqërisë civile. Institucioni partner i asociuar duhet të ndodhet në të njëjtin kontinent me institucionin partner të konsorciumit kryesor. Institucionet partnere të asociuara mund të marrin fonde. Sidoqoftë, shuma e të gjitha institucioneve partnere të asociuara nuk duhet të kalojë 30% të buxhetit të përgjithshëm. Subjektet e sektorit privat mund të përfshihen, por nuk kanë të drejtë të marrin fonde.

### Institucionet e BE-së:

- Institucionet e arsimit të lartë nga vendet anëtare të BE-së mund të përfshihen në një projekt, por nuk kanë të drejtë të marrin fonde.

## Shqipëria dhe Kosova

Për projektet e bashkëpunimit me Shqipërinë dhe Kosovën, vlejnjë kërkesa të veçanta. Ndërsa të gjitha instrumentet janë në dispozicion për partneritetet me institucionet në Kosovë dhe Shqipëri, vetëm projektet e studimit për zhvillim janë të pranueshëm për financim. Projektet me fokus në arsimin e lartë ose forcimin e kapaciteteve menaxheriale nuk janë të pranueshme. Për më tepër, projektet duhet të jenë në përputhje me përparësitë e ADC në Shqipëri dhe Kosovë. Konsorciumet duhet të shtjellojnë përse projekti përshtatet më së miri për APPEAR dhe nuk mund të financohet nga programe të tjera (p.sh. të BE-së).

## Kostot e financuara

Instrumenti	Kostot e personelit	Udhëtimi dhe jetesa	Pajisjet dhe materiali	Shpërndarja	Kosto të tjera	Mbingar kesë
Financimi përgatitor	x	x			x	maks. 2%
Partneriteti akademik	x	x	x	x	x	maks. 10%
Partneriteti i avancuar akademik	x	x	x	x	x	maks. 10%
Partneriteti i ndikimit të zgjeruar	x	x	x	x	x	maks. 10%

## Bursat për master dhe doktoraturë

Një objektivi i APPEAR është që institucionet e arsimit të lartë në vendet e pranueshme të rrisin numrin e tyre të personelit të kualifikuar të cilit i jepet mundësia të kontribuojë në përmirësimin e mësimdhënies, studimit dhe menaxhimit në institucionet e tyre. Studentët dhe profesionistët nga vendet e pranueshme përfundojnë studimet e tyre për master ose doktoraturë në një universitet austriak. Të paktën 70% e bursave duhet t'u jepet studentëve të masterit dhe të doktoraturës që janë të përfshirë në një partneritet APPEAR. Të paktën 50% e bursave individuale do t'u jepen aplikanteve femra.

Ka dy lloje të bursave APPEAR:

- Bursat për master dhe për doktoraturë që janë të integruara në një partneritet të vazhdueshëm APPEAR.
- Bursat e doktoraturës që janë individuale, d.m.th. nuk janë të integruara në një partneritet të vazhdueshëm APPEAR.

## Kërkesat

- Aplikanti emërohet nga institucioni vendas. Institucioni konfirmon që bursa u shërben kërkesave specifike të institucionit dhe nevojave të zhvillimit të vendit të origjinës (p.sh. brenda planit të menaxhimit të institucionit të arsimit të lartë) dhe se aplikanti është i punësuar dhe do të rimerret në punë nga institucioni.
- Nëse projekti i studimit (d.m.th. bursa) është e përfshirë në një partneritet të vazhdueshëm APPEAR, koordinatori i partneritetit përshkruan se si projekti i studimit do të kontribuojë në objektivin e partneritetit.
- Konfirmimi i pranimit të projektit të studimit nga një mbikëqyrës shkencor në institucionin austriak që organizon bursën
- Aplikanti konfirmon qëllimin e tij/saj për t'u kthyer në vendin e lindjes pas përfundimit të projektit të studimit dhe për të ndjekur një detyrë të përshtatshme, të lidhur me zhvillimin.

## Kostot e financuara

Studimet e masterit: 1000 euro në muaj (deri në 24 muaj)

Studimet e doktoraturës: 1100 euro në muaj (deri në 48 muaj)

Kostot e udhëtimit (duke përfshirë studimet në terren në vendin e lindjes) dhe grantet shtesë (kursi gjermanisht, pjesëmarrja në konferenca/kurse, kuota e tezës)

## Thirrjet

Thirrja e parë për financim brenda APPEAR III parashikohet të hapet në fillim të vitit 2021. Do të ketë thirrje të mëtejshme në 2022, 2023 dhe 2024.

## Kontakt dhe informacion

Zyra e APPEAR

në OeAD-GmbH - Agjencia për Arsim dhe Ndërkombëtarizim e Austrisë

Ebendorferstrasse 7

1010 Vienna, Austria

Email: [appear@oead.at](mailto:appear@oead.at)

Web: [www.appear.at](http://www.appear.at)